



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju

Kosovo Accreditation Agency

Data: 11.08.2017

Ref.: 694/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.573/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji "AAB" për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.586/17, datë 06.07.2017.
- II. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit sipas vendimit nr.586/17, datë 06.07.2017 për programin e studimit të BPrAL Kolegji AAB kampusi në Prishtinë:
 - Arkitekturë, BA, 180 ECTS;
 - Marketing dhe Menaxhim Biznesi, MA, 120 ECTS;
 - Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS;
 - Shkenca Kompjuterike, MSc, 120 ECTS;
 - Menaxhment dhe Informatikë, MA, 120 ECTS;
 - Komunikim Masiv – Gazetari, MA, 120 ECTS
 - Kulturë Fizike dhe Sport, MA, 60 ECTS.
- III. Hiqet masa e pezullimit të akreditimit për programin e studimit të BPrAL Kolegji "AAB" dega në Gjakovë:
 - Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS;
 - Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 180 ECTS.
- IV. Lejohet regjistrimi i studenteve në programet e cekura në pikën dy dhe tre të këtij vendimi.
- V. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së nr.586/17, datë 06.07.2017 mbetet e pa ndryshuar.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji AAB me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 586/17, datë 06.07.2017, me të cilin vendim Kolegjit AAB i është pezulluar akreditimi për programe të studimit: për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018 në kampusin në Prishtinë: Arkitekturë, BA, 180 ECTS; Arkitekturë, MA, 120 ECTS; Juridik Penal, LL.M, 60 ECTS; Marketing dhe Menaxhim Biznesi, MA, 120 ECTS; Banka dhe Financa, MSc, 120 ECTS; Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS; Shkenca Kompjuterike, MSc, 120 ECTS; Menaxhment dhe Informatikë, MA, 120 ECTS; Komunikim Masiv – Gazetari, MA, 120 ECTS; Kulturë Fizike dhe Sport, MA, 60 ECTS; Politikat Sociale dhe Mirëqenja e Fëmijëve, MA, 120 ECTS. Në Kolegjin AAB dega në Gjakovë janë pezulluar këto programe: Banka, Financa, Kontabilitet, BA, 180 ECTS; Menaxhment dhe Informatike, BSc, 180 ECTS; Administratë Publike, BA, 180 ECTS; Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 180 ECTS, dhe Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS. Në Kolegjin AAB dega në Ferizaj është pezulluar programi: Marketing dhe Administrim Biznesi, BA, 180 ECTS.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga BPrAL Kolegji AAB, është konstatuar që programet e cekura në pikën dy (2) dhe tre (3) të këtij vendimi, i plotëson kushtet sa i përket stafit akademik që parashihen me Udhëzimin Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, nenit 11, pika 3.2. Sipas kësaj pike, Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL) duhet të ketë të paktën tre persona në marrëdhënie të rregullt pune të nivelit PhD për secilin program të studimit.

Për programet e tjera të pezulluara me vendim (nr.586/17, datë 06.07.2017), të KSHC ka konstatuar që bartësit e këtyre programeve nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë bartës të këtyre programeve.

Bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji AAB;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

